



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.852/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri, kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e Arbëresha Berishës kandidate për kuvendin komunal në Prizren nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar apeli i Arbëresha Berishës kandidate për kuvendin komunal në Prizren nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prizren nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren për vendvotimet: 2002A/05R; 2002A/06D; 2003A/05R; 2004A/01R; 2008A/01R

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimet si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një apel më datë 10.11.2017 në ora 10:00 nga Arbëresha Berishës kandidate për kuvendin komunal në Prizren nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren në të cilën thekson se vendvotimet 2002A/06R; 2002A/06D; 2003A/05R; 2004A/01R; 2008A/01R nuk i janë bartur votat e saja në FRK.

Parashtruesja e apelit kërkon nga PZAP-i që ky apel të pranohet si i bazuar dhe ti urdhërohet KQZ-së që të vërtetojë gjendjen e saktë faktike

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara, për faktin se pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës si dhe dëshmive të ofruara nga ankuesja që gjenden në shkresat e lëndës dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga vendimi i KQZ-së me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit për vendvotimet e lartcekura si më lart, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prizren nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren për vendvotimet e lartcekura, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL A nr. 852/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.